

**URDHËR**  
**Nr. 100, datë 10.2.2021**

**PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, FAST FOOD  
DHE LOKALEVE**

Në zbatim të nenit 7, pika 4 germa “b” të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809 datë 10.02.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

**URDHËROJ:**

1. Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, *fast-food* dhe lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët, nga ora 20:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 11.2.2021 deri në datën 25.2.2021.

2. Përrjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1, bëhet vetëm për shërbimin në banesë (*delivery*), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19” i ndryshuar.

4. Çdo urdhër i mëparshëm në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Ogerta Manastirliu**